



Energy Regulatory Office
Zyra e Rregullatorit për Energji
Regulatorni Ured za Energiju

Hamdi Mramori Street, No 1
Prishtina 10000 – Kosovo
Tel: +381 (0) 38 247 615 ext. 101
Fax: +381 (0) 38 247 620
e-mail: info@ero-ks.org
www.ero-ks.org

Draft

DORACAK I RAPORTIMIT

Për Sektorin e Energjisë

Përmbajta

1.	Parathënie	3
1.1.	Emri i Kompanisë suaj dhe Përgjegjësitë e ZRRE-së	3
1.2.	Çka bënë Doracaku i Raportimit?	3
1.3.	Pyetjet dhe Kontaktimi me ZRRE-në	3
2.	Duke u Siguruar se jeni në pajtuesmëri me Liçencën tuaj	4
2.1.	Organizimi i Kompanisë Suaj për t’i Kushtuar Kujdes Pajtueshmërisë	4
2.2.	Duke siguruar që kompania juaj i kupton plotësisht obligimet ndaj liçencës suaj	4
2.3.	Pregaditja dhe Dorëzimi i Raporteve të Pajtueshmërisë	4
3.	Raportimi në ZRRE mbi Pajtueshmërinë	5
3.1.	Përshkrimi i Raportimit të Pajtueshmërisë	5
3.2.	Klasifikimi i Kushteve të Liçencës	6
3.3.	Njoftimi Vjetor	7
3.4.	Si të dërgohen Raporte Tremujore dhe Vjetore?	8
4.	Çka Ndodh më Tutje: Kontrollomi i Kthimeve tuaja dhe Nivelet e Mira dhe të Këqija të Pajtueshmërisë	8
4.1.	Auditimi i Pajtueshmërisë	9
4.2.	Përgjigja ndaj Mbikëqyrjes së Niveleve të Pajtueshmërisë	9
	ANEKSI A: Njoftim i Menjëhershëm me Fax (< 3 ditë)	11
	Lista e Mos-Pajtueshmërisë së Menjëhershme	11
	ANEKSI B: Formulari i Raportit Tremujor të Pajtueshmërisë – që i Liçencuari e dorëzon në ZRRE	12
	ANEKSI C: Formulari i Raportit Tremujor i Listës së Mos-Pajtueshmërisë: Mos-Pajtueshmëri më Kushtet e Liçencës së Nivelit B	13
	ANEKSI D: Formulari i Raportit Vjetor të Pajtueshmërisë – që i Liçencuari e dorëzon në ZRRE	15
	ANEKSI E: Formulari i Raportit Vjetor i Listës së Mos-Pajtueshmërisë: Përmbledhja e Mos-Pajtueshmërisë së bashku me Kushtet e Licencave gjatë një Viti Financiar	16
	ANNEX F: Tabela e Referencave për shqyrtimin e Kushteve të Licencës	
	Tabela e Monitorimit të Kushteve të Licencës për Gjenerim	17
	Tabela e Monitorimit të Kushteve të Licencës për OST	
	Tabela e Monitorimit të Kushteve të Licencës për Operatorin e Tregut	
	Tabela e Monitorimit të Kushteve të Licencës për OSSH	33
	Tabela e Monitorimit të Kushteve të Licencës për Furnizim/Tregti	45

1. Parathënie

1.1. Emri i Kompanisë suaj dhe Përgjegjësitë e ZRRE-së

Është përgjegjësi e kompanisë suaj si i Licencuar të pajtoheni me të gjitha kushtet e Licencave të lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE).

Përgjegjësia e ZRRE-së është të monitoroj Pajtueshmërinë e Kompanisë suaj me kushtet e Licencave, dhe të marr masa të duhura. ZRRE-ja ka fuqi ta bëjë këtë sipas Nenit 15.2(b), 54(a) dhe 56.1(a) të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

1.2. Çka bënë Doracakun i Raportimit ?

Qëllimi i këtij Doracakun të Raportimit është t'u ndihmoj juve për pajtueshmërinë me obligimet në Kushtet e Licencave tuaja. Kjo do të shpjegojë:

- (a) si do të organizoni ju Kompaninë tuaj për t'i dhënë rëndësi adekuate pajtueshmërisë, dhe të provoni të siguron qe të arrini pajtueshmëri të plotë;
- (b) si ju mund të siguron qe Kompania juaj të kuptojë plotësisht obligimet e licencave;
- (c) cilat janë obligimet e juaja për raportimin mbi pajtueshmërinë ndaj ZRRE-së; dhe
- (d) cilat masa ZRRE-ja mund të ndër marrë në rast të pajtueshmërisë ose mos-pajtueshmërisë së niveleve të ndryshme.

1.3. Pyetjet dhe Kontaktimi me ZRRE-në

Ky doracak është përgatitur për të ndihmuar Kompaninë tuaj me pajtueshmërinë e licencave. Nëse keni ndonjë pyetje për këtë Doracak ose në përgjithësi për pajtueshmërinë, iu lutem kontaktoni kontakt personin për këtë çështje në ZRRE:

Emri: Z. Afrim Ajvazi

Adresa: Zyrtar i Monitorimit të Pajtueshmërisë
(Compliance Monitoring Officer)
Zyra e Rregullatorit për Energji
Rr. "Hamdi Mramori" Nr.1
10000 Prishtinë

Tel: 038-247-615 ext.114

Fax: 038-247-620

E-mail: afrim.ajvazi@eumuik.org

2. Duke u Siguruar se jeni në pajtueshmëri me Licencën tuaj

Ka një numër të gjërave të cilat ju duhet ti ndërmerni e që do ju ndihmojnë që ju të jeni në pajtueshmëri me licencat e juaja, dhe për të raportuar mbi pajtueshmërinë me ZRRE-në. Në këtë Doracak ne ofrojmë shpjegime dhe këshilla mbi këtë në tre fusha kryesore:

1. Organizimi i gjërave brenda kompanisë suaj për të siguruar që ju i kushtoni kujdes adekuat pajtueshmërisë,
2. Të Kujdeseni që kompania juaj i kupton plotësisht obligimet që dalin nga licenca e juaj.
3. Raportimi në ZRRE mbi statusin e pajtueshmërisë së kompanisë suaj.

Ky Doracak ka të bëjë me këto tre fusha në vijim.

2.1. Organizimi i Kompanisë Suaj ashtu që t'i Kushtoj Kujdes Pajtueshmërisë

Personi kryesor përgjegjës në kompaninë tuaj për pajtueshmëri është Drejtori Ekzekutiv (DE). DE është përgjegjës për të siguruar pajtueshmërinë, dhe për dorëzimin e raporteve të pajtueshmërisë në ZRRE.

Për t'i ndihmuar DE-së të përmbush obligimet e tij ne rekomandojmë që kompania juaj të emëroj një Zyrtar të Pajtueshmërisë i cili ka përgjegjësi të përditshme për menaxhimin e procesit të pajtueshmërisë brenda organizatës. Ne propozojmë që Zyrtari i Pajtueshmërisë i kompanisë duhet që të:

- Mirëmbajë kontakt të rregullt me Zyrtarin e Monitorimit të Pajtueshmërisë në ZRRE, ashtu që çdo pyetje ose problem të zgjidhet shpejt dhe lehtë;
- Siguroj që pajtueshmërisë t'i jepet kujdes adekuat nga të gjithë stafi i kompanisë, duke siguruar që një anëtar i stafit të identifikohet si përgjegjës për ç'do obligim specifik të licencës; dhe
- Të jetë përgjegjës për përgatitjen e raporteve të pajtueshmërisë të cilat DE-ja duhet të dorëzoj në ZRRE në termin të caktuar kohorë.

2.2. Të kujdeseni që kompania juaj i kupton plotësisht obligimet që dalin nga licenca e juaj

Një hap kyç për të siguruar pajtueshmëri të plotë është të kujdeseni që obligimet që dalin nga licenca e lëshuar të kuptohen plotësisht nga kompania juaj dhe i gjithë stafi relevant në të. DE-ja dhe Zyrtari i Pajtueshmërisë duhet të rishikoj Licencat e Kompanisë dhe të:

- Identifikoj të gjitha obligimet e licencave të cilat duhet të përmbushen si të plota apo ato obligime të vazhdueshme; dhe
- Dominoj anëtar relevant të përgjegjshëm për çdo obligim specifik (p.sh dorëzimi i llogarive), ashtu që ata do të mund të punojnë me Zyrtarin e Pajtueshmërisë dhe DE-në për të siguruar pajtueshmëri.

Nëse ky rishikim identifikon ndonjë pyetje ose shqetësim, DE-ja ose Zyrtari i Pajtueshmërisë duhet ta parashtrojë atë menjëherë me ZRRE-në, për të shmangur probleme të mëvonshme. Kompania juaj duhet poashtu të marr pjesë në ç'do takim pune ose prezantim që cilat mbahet nga ZRRE-ja për t'iu asistuar juve në Monitorimin e Pajtueshmërisë.

2.3. Përgatitja dhe Dorëzimi i Raporteve mbi Pajtueshmërinë

Si shtesë për të siguruar që të gjitha obligimet e licencave të plotësohen, ju poashtu duhet të dorëzoni në ZRRE raporte të rregullta se veproni në pajtueshmëri me licencën, e cila mundëson

monitorimin e pajtueshmërisë. Pjesa në vijim e këtij Doracakut përshkruan se çka duhet të përmbajnë këto raporte, poashtu kur dhe si duhet ato të dorëzohen.

3. Raportimi në ZRRE-së mbi Pajtueshmërinë

3.1 Përshkrimi i Raportimit të Pajtueshmërisë

Prioritet i parë i juaji duhet të jetë sigurimi se të gjitha obligimet e dala nga licencat duhet të plotësohen. Mirëpo poashtu shumë e rëndësishme është që ju të dorëzoni raporte të rregullta mbi pajtueshmërinë në ZRRE, për të mundur pajtueshmërinë tuaj. Ne do të shpjegojmë më poshtë se çka këto raporte të pajtueshmërisë duhet të përmbajnë, poashtu kur dhe si ato duhet të dorëzohen.

Ju iu nevojitet të dorëzoni lloje të ndryshme të raporteve në termine të ndryshme kohore, varësisht nga rrethanat edhe poqëse supozohet që nuk ka pas pajtueshmëri. Tabela Nr.1 më poshtë përmbledh këto lloje të ndryshme të raporteve, dhe datat kur ato duhet të dorëzohen. Në shpjegojmë më poshtë qëllimet e këtyre llojeve të ndryshme të raporteve, dhe se çka ato duhet të përmbajnë.

Tabela 1: Cikli i Raportimit në ZRRE

Lloji i Raportit	Kur duhet të Dorëzohet				
		TM1	TM2	TM3	Vjetor
Raport-Njoftimi i Menjëhershëm për Mos-Pajtueshmëri Serioze (me Fax/Emali)	Sipas Nevojës	-	-	-	-
Raporti Tremujor i Pajtueshmërisë (me Orarin e Mos-Pajtueshmërisë nëse është relevante)	-	30 Prill çdo vit	31 Korrik çdo vit	31 Tetor çdo vit	-
Raporti Vjetor i Pajtueshmërisë (me Orarin e Mos-Pajtueshmërisë nëse është relevante)	-	-	-	-	31 Janar çdo vit

3.1.1 Raport Njoftimi i Menjëhershëm

Ju duhet të dorëzoni në ZRRE Raport-Njoftimi të Menjëhershëm kurdo që jeni në dijeni që ka ndonjë shkelje të kushteve të licencës në kompaninë tuaj. Kjo nënkupton shkelje të kushteve të “Nivelit A” në licencë – ne do të shpjegojmë më poshtë se çka do të thotë kjo. Shkeljet të cilat janë më pak serioze (shkelje të kushteve të “Nivelit B”) nuk ka nevojë të raportohen menjëherë, por mund të përfshihen në raportet relevante tremujore apo vjetore. Nëse keni dyshime se ka paqartësi mbi atë se a ka shkelje apo jo të kushteve, dhe se a duhet të raportohen apo jo, ju duhet të merrni atë si shkelje të kushteve dhe të raportoni atë në ZRRE.

3.1.2 Raporti Tremujor i Pajtueshmërisë

Çdo tre muaj, ju duhet të dorëzoni raport tremujor në ZRRE. Kjo duhet të përmbajë Raportin e Pajtueshmërisë në formatin si në Aneksi B e cila konfirmon që ju jeni në pajtueshmëri me të gjitha Kushtet e licencës suaj. Nëse ndonjë nga këto Kushte janë shkelur në tre muajt e kaluar

deri në ditën e raportimit ato duhet të regjistrohen në Raport – kjo duhet të jetë në formën e Raportit Tremujor mbi Mospajtueshmërinë si në Shtojcën C.

3.1.3 Raportimi Vjetor i Pajtueshmërisë

Në fund të Janarit të çdo viti, ju duhet të dorëzoni në ZRRE Raportin Vjetor të Pajtueshmërisë në formën e paraparë nga Shtojca D. Kjo duhet të konfirmoj që ju jeni në pajtueshmëri me të gjitha Kushtet e licencës, ku, nëse ka pasur ndonjë shkelje të Kushteve gjate vitit të shkuar, këto duhet të raportohen në Raport – kjo duhet të jetë në formën e Raportit Vjetor mbi Mospajtueshmërinë si në Shtojcën E.

3.1.4 Llojet e Ndryshme të Shkeljeve

Disa shkelje janë më serioze sesa disa të tjera, dhe për atë ne i kemi klasifikuar në kushtet e licencës në dy kategori – të Nivelit A dhe B të përmendura më lartë. Kjo mundëson prioritetin e raportimit të shkeljeve, dhe këto shpjegohen më qartë më poshtë.

3.2 Klasifikimi i Kushteve të Licencës

Sistemi i ZRRE-së në pajtueshmërinë e licencave është i bazuar mbi sistemin që i klasifikon kushtet e Licencës sipas rëndësisë së tyre.

Për ato Kushte në Licencën tuaj që janë të një rëndësie të veçantë, ZRRE dëshiron të dijë më herët për shkeljet e tyre sesa për ato Kushte të një rëndësie më të vogël. ZRRE-ja poashtu do të reagoj ndryshe varësisht nga ajo se cili Kusht është shkelur. Definimi i asaj të një rëndësie të veçantë në këtë kontekst varet nga efekti potencial i shkeljes mbi Politikat Qeveritare dhe konsumatorët, dhe mbi koston për kompensim.

Ne i definojmë këto dy kategori të Kushteve në mënyrën si në vijim:

Niveli A i kushteve janë ato kushte të licencës ku shkelja do të ketë ndikimi serioz potencial mbi objektivat e politikave të Qeverisë ose mbi konsumatorët ose koston e kompensimit.

Niveli B i kushteve janë ato kushte të licencave të cilat kanë një ndikim potencial më të vogël të rrezikshmërisë si në objektivat e politikave të Qeverisë dhe mbi konsumatorët.

Niveli i alokuar i çdo kushti të licencës përcakton shpejtësinë me të cilën pritet që ta njoftoni ZRRE-në për mos pajtueshmëri, si në shpjegimin në vijim:

- Ju duhet të dërgoni Raport Njoftimi të Menjëhershëm në ZRRE menjëherë nëse ka shkelje të Kushteve të Nivelit A;
- Raporti i rregullt i Pajtueshmërisë që duhet ta dërgoni për çdo Tre muaj dhe çdo Vit në ZRRE duhet të përfshijë detaje të mos pajtueshmërisë të kushteve të Nivelit B.

Tabelat referuese në Aneksin F tregojnë nivelin e alokuar për të gjitha kushtet në të gjitha Licencat e lëshuara nga ZRRE-ja.

3.2.1 Kushtet e Nivelit A – Njoftim i Menjëhershëm

Ju duhet që menjëherë të raportoni shkelje të kushteve të Nivelit A në ZRRE. “Menjëherë” nënkupton që ju duhet të raportoni shkeljen sa më shpejtë që është e mundshme, dhe brenda maksimum 3 ditëve pune kur shkelja ndodh.

Për të bërë njoftim të kënaqshëm, **brenda 3 Ditëve Pune** ju duhet t'i dërgoni një kopje të raportit të njoftimit me Fax apo E-mail Zyrtarit për Monitorimin e Pajtueshmërisë sikurse është cekur në Nenin 1.3. Një format i njoftimit të menjëhershëm i njoftimit që do të dërgohet me fax apo e-mail është formuluar në Aneksin A të këtij Doracaku.

Raport-Njoftimi juaj i cili do të dërgohet me faks apo me e-mail duhet të përmbaj:

- Kohëzgjatjen dhe natyrën e mos-pajtueshmërisë (përfshirë atë se sa konsumator dhe/ose mbajtës tjerë të licencave janë ndikuar nga kjo);
- Arsyet për mos-pajtueshmëri së bashku me kushtin(et);
- Masat të cilat ju i merrni për të korrigjuar shkeljet dhe për t'i parandaluar ato që të përsëriten;
- Datat e pritura kur ju e konsideroni që do të jeni në pajtueshmëri me kushtin(et).

Sa për sqarim, çdo shkelje e Nivelit A duhet të përmbledhet në pak fjalë dhe të raportohet në raportin vjetor të pajtueshmërisë, përfshirë dhe informata të freskëta për masat e mëtutjeshme të ndërmarra sa i përket shkeljes, nëse shkelja vazhdon, dhe një përmbledhje të statusit të tanishëm të shkeljes.

3.2.2 Kushtet e Nivelit B – Njoftimi Tremujor

Ju duhet të raportoni shkeljet e Nivelit B të kushteve të licencës vetëm në raporte tremujore, duke pasuar me një orar kohor në formë tablele të paraqitur në Tabelën 1.

Një raport i ndarë tremujor duhet të dorëzohet në ZRRE për çdo licencë që ju e mbani, dhe çdo raport duhet të konstatoj:

- gjendjen dhe nivelin me të cilën ju keni qenë në pajtueshmëri me Kushtet në atë tremujor;
- ku ju nuk keni qenë në pajtueshmëri me çfarëdo kushti të Nivelit B gjatë atij Tremujori ju duhet që t'i shënoni ato, dhe të përfshini një raport shtesë (Raporti për mos-pajtueshmëri) së bashku me Raportin e Pajtueshmërisë dhe
- regjistroni çdo shkelje të Nivelit A që e keni raportuar gjatë këtij tremujori, përfshirë çdo masë të mëtutjeshme të ndërmarr si pasojë e shkeljes, edhe atëherë kur shkelja vazhdon, dhe një përmbledhje të gjendjes së tanishme të shkeljes.

Lista e Raportit Tremujor e Mos-Pajtueshmërisë që ju duhet të dorëzoni duhet të përmbajë:

- masën dhe natyrën e mos-pajtueshmërisë (përfshirë atë se sa konsumatorë dhe /ose mbajtës të licencave janë prekur nga ajo);
- arsyet për mos-pajtueshmëri;
- masat e ndërmarra për kompensimin e shkeljeve dhe parandalimin e tyre;
- gjendjen e tanishme të shkeljes;
- datën aktuale apo atë të pritur të pajtueshmërisë së plotë.

Sa për sqarim, çdo shkelje e raportuar në raportin e pajtueshmërisë tremujor duhet poashtu të përmbledhet edhe në raportin vjetor të pajtueshmërisë, përfshirë statusin e raportit dhe të dhëna të reja mbi masat që janë marr nga mbajtësit e licencave për çdo shkelje.

Formularët për Raportin Tremujor të Pajtueshmërisë dhe Orari Tremujor i Mos-Pajtueshmërisë që i bashkëngjitet të cilat së bashku duhet të dërgohen në ZRRE, mund t'i gjeni më poshtë në Aneksin B dhe C të këtij Doracaku.

3.3 Njoftimi Vjetor

Raporti Vjetor mbi pajtueshmërinë duhet të dërgohet në ZRRE në fund të çdo viti, siç është shënuar në Tabelën 1.

Raporti duhet të paraqes masën me të cilën ju keni qenë në pajtueshmëri me Kushtet e Nivelit A dhe Nivelit B gjatë vitit të kaluar. Ky raport duhet të autorizohet nga Drejtori Ekzekutiv i Kompanisë së Licencuar, i cili poashtu duhet të nënshkruaj të gjithë formularët e kërkuar në Tabelën e Referimit në Aneksin F, dhe të aprovohet nga Bordi i kompanisë në fjalë. Nëse në ndonjë formular ka indikacione që nuk ka pasë pajtueshmëri me ndonjë nga kushtet e parashtruara, detajet e mos-pajtueshmërisë duhet të paraqiten në Listën Vjetore të Mos-Pajtueshmërisë (shiko Aneksin E).

Çdo mos-pajtueshmëri e Kushteve të Nivelit A duhet tanimë të njoftohen në ZRRE, mirëpo në Raportin Vjetor ju duhet ofroni detaje për çdo mos-pajtueshmëri që nuk është raportuar deri më tani, duke përdorur Listën e Mos-Pajtueshmërisë vjetore në Aneksin E. një freskim i të dhënave mbi çdo shkelje të Nivelit A më herët të raportuar, përfshirë edhe ato që kanë vazhduar prej periudhave të më hershme.

Çdo mos-pajtueshmëri me kushtet e Nivelit B tanimë duhet të jenë të raportuara në ZRRE. Përveç atyre që kanë ndodhë në afatin e fundit Tremujor para dorëzimit të raportit vjetor.

Ky Raport Vjetor duhet të përmbaj detaje të:

- çfarëdo mos pajtueshmërie të Nivelit B që nuk është njoftuar ZRRE-ja më herët, duke përdorur Listën Vjetore për Mos-Pajtueshmëri në Aneksin E; dhe
- një freskim të të dhënave mbi të gjitha shkeljet e Nivelit B që kanë ndodhur gjatë vitit, ose të vazhduara nga periudha e mëhershme, duke përdorur Listën Vjetor të Mos-Pajtueshmërisë në aneksin E.

Forma e Raportit Vjetor të Pajtueshmërisë i cili do të dërgohet në ZRRE është i paraqitur në Aneksin D të Këtij Doracaku.

Çdo listë e Mos-Pajtueshmërisë e dorëzuar me Raportin Vjetor duhet të përmbajë detajet e kërkuara që janë të shpjeguara në Aneksin E të këtij Doracaku.

3.4 Si të dërgojmë Raporte Tremujore dhe Vjetore ?

Në kohë të caktuara (shiko Tabelën 1 më lartë) ju duhet të dorëzoni Raportet Tremujore dhe ato Vjetore tek Zyrtari i Monitorimit të Pajtueshmërisë në ZRRE, detajet e të cilit janë dhënë në Nenin 1.3.

Raportet duhet të dërgohen ose si të bashkangjitura në e-mail (në format të lexueshme p.sh Word file ose .pdf format), ose të dorëzohen personalisht apo me postë.

4. Çka Ndodh më Tutje: Verifikimi i raporteve tuaja si dhe vlerësimin e Niveleve të Mira apo të Dobëta të Pajtueshmërisë

ZRRE-ja vendos përgjegjësinë mbi të Licencuarit të ofrojnë informata të sakta dhe të besueshme në ZRRE mbi pajtueshmërinë me kushtet e licencave. Kjo qasje është edhe efikase dhe kosto-efektive për të Licencuarit dhe për ZRRE-në sepse i shmanget kontrollimeve të vazhdueshme të bizneseve të të Licencuarve nga stafi i ZRRE-së apo palët e treta.

Mirëpo, për të shmangur keqpërdorim të këtij sistemi ZRRE do të bëjë kontrollime periodike në vend mbi vërtetësinë e raporteve, dhe mund të përdor ekspertë të jashtëm për t'i konfirmuar këto të dhëna dhe rezultatet që ju i keni ofruar ZRRE-së në raportet e juaja. Ky proces i verifikimit mund të përfshijë auditim të performancës dhe të sistemit të të dhënave tuaja dhe rezultateve.

ZRRE-ja poashtu ka fuqinë për të marr masa dhe ndëshkime administrative në pajtim me Rregullin mbi Masat dhe Gjobat Administrative kundrejt çdo të licencuari i cili mund të ofroj informata të falsifikuara, ose jo të sakta.

4.1 Auditimi i Pajtuëshmërisë

ZRRE-ja poashtu periodikisht do të mandatoj auditim të pajtuëshmërisë ndaj të Licencuarve të përzgjedhur. Fushëveprimi dhe koha e këtyre auditimeve do të varet nga rezultatet e mëhershme të auditimeve të pajtuëshmërisë dhe të historianit të pajtuëshmërisë të çdo biznesi të licencuar.

Auditimet e pajtuëshmërisë mund të bëhet në njërën prej mënyrave si në vijim:

- Një **auditim të sistemit**: kjo mund të kontrollojë sistemet, proceset dhe procedurat e TI-së tuaj (Teknologjisë Informative) (softuerin dhe harduerin) që i keni të vendosura në biznesin tuaj, ku do të fokusohet në kontrollimin e asaj se çfarë sisteme dhe procese janë të adoptuara, për të siguruar që jeni në pajtuëshmëri me të gjitha kushtet e licencave. Auditimi do t'i adresohet nivelit tuaj menaxherial dhe përkushtuëshmërisë së stafit për pajtuëshmëri, pra masën së deri ku ju i mbështetni politikat e pajtuëshmërisë dhe informimit të stafit tuaj për të kuptuar dhe përkrahur sistemin menaxherial të pajtuëshmërisë. Një sistem i kualifikuar i auditimit nuk do të thotë detyrimisht që ju keni shkelur ndonjë nga kushtet e licencës suaj, mirëpo, do të alarmoj ZRRE-në se çka mund të ndodhë në rast shkeljeje e ndoshta edhe udhëzoj ZRRE-në në të ardhmen në marrjen e vendimeve mbi vlerësimin e pajtuëshmërisë në kompaninë tuaj.
- Një **auditim të përformancës**: kjo është një kontroll i përformancës suaj për të shikuar nivelin e pajtuëshmërisë me kushtet. Vlerëson masën se sa ju jeni në pajtuëshmëri me kushtet e licencës. Ky tip i auditimit mund poashtu të përfshijë një auditor i cili do të krijoj dhe shpreh një opinion mbi besueshmërinë e informatave të dorëzuara në ZRRE në raportin tuaj vjetor të pajtuëshmërisë.

Këto auditime mund të ndërmiren nga ZRRE-ja dhe/ose ekspertët e pavarur, ndërsa shpenzimet e çdo auditimi që ZRRE-ja kërkon do të jenë përgjegjësi e të Licencuarit. Mirëpo procesi do t'i nënshtrohet procesit të tenderimit konform rregulloreve të EU-së.

Për shkak të natyrës së ndryshueshme të fushëveprimit dhe kohës së auditimeve prej vitit në vit, kushtet të cilat do të auditohen nuk janë të përkufizuara në Doracakun e Raportimit. Fushëveprimi i çdo auditimi të planifikuar do t'u ofrohet ndaras të gjithë bizneseve në afatë të ngushtë me kohën kur do të ndodhë auditimi.

4.2 Përgjigja ndaj Niveleve të Mbikëqyrura të Pajtuëshmërisë

Në këtë fazë, nuk ka ndonjë historiat të pajtuëshmërisë së mirë apo të dobët të kompanisë suaj, dhe poashtu do të nevojiten një numër vitesh për atë të zhvillohet.

Mirëpo, ZRRE'ja pret të shoh ndryshimin në atë se në çfarë mase të licencuarit i qasen pajtuëshmërisë me kushtet e licencave të tyre. ZRRE'ja do të shpërblej të licencuarit të cilët përformojnë më mirë se të Licencuarit e tjerë në këtë fushë, sikurse për pajtuëshmëri poashtu dhe në raportimin e saktë të pajtuëshmërisë. Për atë iu inkurajojmë të përdorni përpjekjet më të mira që të zbatoni obligimet e pajtuëshmërisë suaj.

ZRRE'ja pret të shpërblej të gjithë të licencuarit që kanë përformanca të mira. Kjo mund të bëhet në formën e zvogëlimit të shpeshtësisë së raportimit të pajtuëshmërisë për të Licencuarit të cilët mund të dëshmojnë që:

- kanë një sistem të fortë pajtueshmërisë;
- kanë pranë një raport të kënaqshëm të auditimit lidhur me pajtueshmërinë; dhe
- kanë një histori të mirë të pajtueshmërisë.

Mirëpo, ather kur të Licencuarit dështojnë të jenë në pajtueshmëri me kushtet kyçe ose nuk e implementojnë një sistem të përshtatshëm të pajtueshmërisë, ZRRE'ja në mënyrë progresive mund të rritë frekuencën e kërkesës për raportim dhe auditim të pajtueshmërisë, ose vendos ndëshkime të tjera.

Kur një i Licencuar pranë një raport të auditimit marginal apo jo adekuat, mund t'i nënshtrohet hetimeve të mëtutjeshme.

Si shtesë, ku ka indikacione të theksuara të problemeve në mos-pajtueshmëri me sistemin e pajtueshmërisë, i Licencuari mund të detyrohet t'i nënshtrohet një auditimi të jashtëm para së ose në ndërlidhje me dorëzimin e raportit vjetor vijues për ZRRE'n.

ANEKSI A: Njoftim i Menjëhershëm me Faks (< 3 ditë)

Dorëzuar nga: *[emri, posti i personit përgjegjës]*

Për: Zyrтарin e Monitorimit të Pajtushmërisë, Departamenti i Ligjor dhe i Licencimit, ZRRE, Prishtinë

[Emri i Kompanisë së licencuar] raporton që:

1. Ky njoftim raporton një shkelje të Nivelit A të kushteve të licencës e cilat duhet të raportohen me njoftim të menjëhershëm në ZRRE.
2. Të dhënat mbi shkeljen e Kushtit(eve) të parapërcaktuara të Nivelit A i kemi ofruar në listën e bashkangjitur.
3. Ky raport i Pajtushmërisë është aprovuar dhe nënshkruar nga Drejtori Ekzekutiv i ...**[Emri i Kompanisë së Licencuar]**.

Data:.....

Nënshkruar

Emri:.....

Titulli:

Lista e Mos-Pajtushmërisë së Menjëhershme

Në këtë listë ju duhet të përfshini gjërat sikurse në vijim:

- Shkeljet e kushtit(eve) të licencës
- Përshkrimin e shkeljes që ka ndodhur
- Datat e shkeljes(eve)
- Shkaqet e shkeljes(eve)
- Masat të cilat duhet të ndërmerren nga i licencuari për të (t'i) përmirësuar shkeljen(et) e kushtit(eve) të licencës, nëse shkelja vazhdon, dhe deri kur pritet që ajo apo ato të riparohen(përmirësohen).

ANEKSI B: Raporti Tremujor i Pajtueshmërisë – që i Licencuari e dorëzon në ZRRE

E dorëzuar nga: *[emri,postei i personit përgjegjës]*

Për : Zyrtarin e Monitorimit të Pajtueshmërisë, Departamenti Ligjor dhe i Licencave, ZRRE, Prishtinë

[Emri] raporton që:

1. Ky raport përmban dokumentet e pajtueshmërisë gjatë periudhës [periudha tremujore] me të gjitha kushtet të cilat i mban licenca nga i Licencuari.
2. Ky raport është përgatitur nga [emri i personit i cili ka përgatitur këtë raport] me të gjithë përgjegjësinë dhe obligimet ndaj tij, në njohuri të plotë të kushteve ndaj të cilave është përgjegjës dhe në pajtueshmëri me Doracakun e Raportimit të ZRRE's.
3. Lista Tremujorëshe e bashkangjitur mbi Mos-Pajtueshmërinë (referoju Aneksit C) ofron informata mbi të gjitha kushtet me të cilat i Licencuarinuk ka qenë në pajtueshmëri gjatë periudhës tremujore.
4. Përveç informatave të ofruara në Listën e Mos-Pajtueshmërisë, i Licencuari vërteton se ka qenë në pajtueshmëri me të gjitha kushtet ndaj të cilave është përgjegjës.
5. Ky raport i pajtueshmërisë është aprovuar dhe nënshkruar nga Drejtori Ekzekutiv i të Licencuarit.

Data:.....

Nënshkruar

Emri:.....

Titulli:

ANEKSI C: Lista e Mos-Pajtueshmërisë: Mos-Pajtueshmëri më Kushtet e Licencës së Nivelit B

E dorëzuar nga: *[emri, posti i personit përgjegjës]*

Për : Zyrтарin e Monitorimit të Pajtueshmërisë, Departamenti Ligjor dhe i Licencave, ZRRE, Prishtinë

Shënim: ku është relevante, të dy tabelat të poshtë shënuara duhet të plotësohen.

Nivelit A i mos Pajtueshmërisë

Nr.	Mos Pajtueshmëri	Data e Njoftimit	Të dhëna të reja për Shkeljen
1			
2			

Shënime :

1. Çdo shkelje e kushteve të niveli A që ka ndodh gjatë këtij tremujori, ose që ende ekziston prej periudhës së mëhershme duhet të përshkruhet në resht të ndara në Tabelë.
2. Në shtyllën e “Mos-Pajtueshmërisë” plotësoje me numrin të Referencës së Doracakut të Raportimit për Kushtin.
3. Në shtyllën e “Të dhëna të reja nga Shkelja” shkurtimisht përshkruaj për ndonjë shkelje të njoftuar më herët:
 - o Masat e ndërmarra korrigjuese pas raportit të mëhershëm; dhe
 - o Statusi i tanishëm i shkeljes.

Nivelit B i mos-Pajtueshmërisë

Nr.	Mos Pajtueshmëri	Komente të Shkurta
1		
2		
3		
4		
5		

Shënim :

- Çdo shkelje e kushteve të Nivelit B duhet të përshkruhen në një resht të ndara në Tabelë.

- Në shtyllën e “Mos-Pajtueshmërisë” plotësoje me numrin të Referencës së Doracakut të Raportimit për Kushtin.
- Në shtyllën e “Komenteve të Shkurta” shkurtimisht përshkruaj:
 - Masën e mos-pajtueshmërisë së ndodhur
 - Shkakun e mundshëm për mos-pajtueshmëri
 - Masat e ndërmarra korrigjuese
 - Statusin e tanishëm së shkeljes

ANEKSI D: Raporti Vjetor i Pajtueshmërisë – që i Licencuari e dorëzon në ZRRE

E dorëzuar nga *[emri, posti i personit përgjegjës]*

Për : Zyrtarin e Monitorimit të Pajtueshmërisë, Departamenti Ligjor dhe i Licencave, ZRRE, Prishtinë

[Emri] raporton:

1. Ky raport përmban dokumentet e pajtueshmërisë gjatë [viti financiar] me kushtet e Nivelit A dhe B të cilat i Licencuari është përgjegjës ndaj [licenca(t) e mbajtura].
2. Ky raport është përgatitur nga [emri i personit kush e ka përgatit] me të gjitha mundësitë dhe aftësitë në njohuri të plotë të kushteve ndaj të cilave mban përgjegjësi dhe në pajtueshmëri me Doracakun e Raportimit të ZRRE's.
3. Lista e bashkangjitur Vjetore e Mos-Pajtueshmërisë (shiqo Shtojcën E) që duhet të ofroj një përmbledhje të të gjitha kushteve me të cilat i Licencuari nuk ka qenë në pajtueshmëri gjatë [viti financiar], përfshirë detajet e çdo mos pajtueshmërie që nuk ka qenë më herët e raportuar.
4. Përveç informatave të ofruara në Listën Vjetore të Mos-Pajtueshmërisë, i Licencuari vërteton që ka qenë në pajtueshmëri me të gjitha kushtet për të cilat është vetë përgjegjëse t'i përmbush.
5. Ky raport ka qenë i aprovuar nga Drejtori Ekzekutiv dhe Bordi i të Licencuarit të [emir] në takimin tyre me [data].

Data:.....

Nënshkruar

Emri:.....

Titulli:

ANEKSI E: Lista e Mos-Pajtueshmërisë: Përmbledhja e Mos-Pajtueshmërisë me Kushtet e Licencës gjatë një Viti Financiar

E dorëzuar nga *[emri, posti i personit përgjegjës]*

Për : Zyrtarin e Monitorimit të Pajtueshmërisë, Departamenti Ligjor dhe i Licencave, ZRRE, Prishtinë

[Emri] raporton:

No.	Mos-Pajtueshmërisë	Kur është ba Njoftimi	Të dhëna të reja mbi Shkeljen
1			
2			
3			
4			
5			

Shënime:

1. Çdo shkelje e kushteve të niveli A ose B që ka ndodh gjatë vitit, duhet të përshkruhet në resht të ndare në Tabelë. Poashtu ju duhet të përfshini edhe ndonjë shkelje të vazhdueshme që ka filluar në periudhën e mëhershme.
2. Në shtyllën e “Mos-Pajtueshmërisë” plotësoje me numrin të Referencës së Doracakut të Raportimit për Kushtin.
3. Në shtyllën e “Kur është njoftuar” plotësoni me datën e njoftimit të mos pajtueshmërisë që më herët i është dorëzuar ZRRE’s.
4. Në shtyllën e “Të dhëna të reja nga Shkelja” shkurtimisht përshkruaj për ndonjë shkelje të njoftuat më herët:
 - o Masat e ndërmarra korrigjuese pas raportit të mëhershëm; dhe
 - o Statusi i tanishëm i shkeljes

Tabela për Monitorimin e Kushteve të Licencës për Gjenerimit

Ref. e Licencës	Niveli i Pajtushmërisë	Përmbajtja e raportimit		
1 Përcaktimet dhe Interpretimet				
1.1 to 1.7	-	Nuk ka nevojë për raportim të Licencës		
2 Llogari të ndara për Biznesin e Gjenerimit				
2.1	A	Licencuari të përgatisë kontabilitetin vjetor rregullativ në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitetin (RAG) dhe ti dorëzoj ZRRE një kopje të audituar të kontabilitetit		
2.2	A	Licencuari të përgatisë kontabilitetin vjetor rregullativ në përputhje me Udhëz. Rregullative për Kontabi.dhe ti dorëzoj ZRRE		
2.3	-	Nuk ka nevojë për raportim të Licencës		
2.4	A	Licencuari nuk ka ndryshuar bazat e tarifimit, shpërndarjes ose alokimit që janë përdorur në vitin financiar parapra		
2.5	A	Licencuari është në pajtushmëri me të gjitha udhëzimet e ZRRE's.		
3 Ndalimi i ndërsubveconeve				
3.1	A	Licencuari nuk ofron/pranon në mënyrë direkt ose indirekt ndërsubvencionime për/prej bizneseve tjera		
4. Ndalimi i diskriminimit				
4.1	B	Licencuari nuk do të diskriminoj blerësit		
4.2	B	Informatat i janë dorëzuar ZRRE's		
4.3	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari		
5. Pajtushmëria me Kodin e Matjes dhe të Rrjetit				
5	B	Licencuari është në pajtushmëri me Kodin e Rrjetit Elektrik dhe Kodin Matës		

6: Marrëveshjet e Sigurisë				
6.1	B	I licencuari ka përgatitur planin për rezervat e karburantit		
6.2	B	I licencuari vepron në përputhje me çdo dispozitë që përcakton llojin dhe masën e minimumit të rezervës së karburanteve		
7. Dispeqingu Qendror				
7.1	B	Licencuari ka dorëzuar të gjitha njësitet e disponueshme të gjenerimit në Dispeqingun Qendror nga OST'ja		
7.2	B	Licencuari i ka ofruar OST's me të gjitha informatat e kërkuara nga ai		
7.3	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari		
8. Shërbimet Ndhmëse				
8.1	B	Licencuari ka ofruar kushte për furnizimin e shërbimeve ndhmëse kur është kërkuar nga OST'ja		
8.2	B	Licencuari ka hyrë në marrëveshje me OST'n		
8.3	B	Licencuari është në pajtueshmëri me Rregullën Mbi Zgjidhjen e Kontesteve		
8.4	B	Licencuari ka hyrë në marrëveshje me OST'n sipas kushteve të përcaktuara nga ZRRE		
8.5	B	Licencuari sipas kërkesës së ZRRE-së i ka siguruar ZRRE-së raportet		
9. Përcaktimi i Operatorit				
9.1	B	Operatori i stacionit të gjenerimit është aprovuar nga ZRRE'ja		
9.2 dhe 9.3	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari		
10. Rregullat e Tregut				
10.1	B	Licencuari është në pajtueshmëri me Rregullat e Tregut		
10.2	B	Licencuari është në pajtueshmëri me Metodologjinë e Tarifave në fuqi		

10.3	B	Licencuari ka vendosur një program të pajtueshmërisë me Rregullat e Tregut		
11. Shëndeti dhe Siguria				
11.1	B	Licencuari ka implementuar programin për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë operimi i gjenerimit për personelin e tij		
11.2	B	Licencuari ka kontraktuar një ekspert të pavarur të ndërmarr auditimin teknik dhe të sigurisë për kapacitetet e tij për çdo vit		
11.3	B	Licencuari ka ofruar raportin e adutimit teknik në ZRRE brenda 3 muajsh nga kompletimi i tyre		
12. Mjedisi				
12.1	B	Licencuari është në pajtueshmëri me të gjitha legjislacionin e ambientit në fuqi në Kosovë		
12.2	B	Licencuari ka ofruar politika të shkruara duke treguar pajtueshmëri sikurse është kërkuar nga ZRRE'ja		
12.3	B	Raporti vjetor mbi performancat ambientale është dorëzuar ZRRE-së		
12.4	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari		
13. Puna				
13	B	Licencuari është në pajtueshmëri me Legjislacionin e aplikueshëm mbi punën		
14. Tjetërsimi dhe Heqja e Aseteve relevante të të Licencuarit				
14.1	A	I Licencuari nuk ka tjetëruar apo braktisur kontrollin operacional mbi ndonjë aset relevant		
14.2	A	Licencuari ka njoftuar me shkrim ZRRE'n për tjetërsimin e ndonjë asemi material		
14.3	A	Licencuari ka njoftuar me shkrim ZRRE'n për heqjen e ndonjë asemi material		
14.4	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari		
15. Obligimi i Sigurimit				
15	B	Licencuari ka lidh kontratë sigurimi për veprimtarinë e gjenerimit		
16. Ndryshim në kontrollin e të Licencuarit				

16	A	Licencuari ka njoftuar ZRRE'n mbi ndryshimin e menaxhmentit të tij		
17. Shërbimet Publike të Detyrueshme				
17	B	Licencuari energji. Elekt. të prodhuar nga ai i ka ofruar furnizuesit publik me çmime të rregulluara nëse ka pas nevojë për e.el.		
18. Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së				
18.1	B	Licencuari ka dorëzuar të gjitha të dhënat/informatat në ZRRE		
18.2 – 18.4	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari		
18.5	B	Licencuari ka vendosur lidhje të komunikimit me OST dhe OT'n		
18.6	B	Licencuari ka ofruar ZRRE-së kopje të nënshkuara të kontratave mbi tregtimit ndër-kufitar, furnizim , blerje të EE		
18.7	B	Licencuari ka dorëzuar ZRRE-së raporte tremujore dhe vjetore mbi veprimtarinë gjeneruese		
18.8	B	Licencuari i ka dërguar ZRRE-së detalet e çdo ndryshimi të informatës së dërguar me aplikacion për licencë		
18.9	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari		
19. Arsyet për Përfundimin, tërheqjen dhe modifikimin e licencës				
19.1 to 19.3	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari		
20. Taksat				
20.1	B	Licencuari ka kryer pagesën e taksës fillestare dhe atë vjetore		
20.2 dhe 20.3	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari		
21. Masat dhe Gjobat Administrative				
21.1 – 21.8	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari `		
20. Zgjidhja e Kontesteve				

22.1 dhe 22.2	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari		
Tabela për Monitorimin e Kushteve të Licencës për OST				
Ref. e Licencës	Niveli i Pajtueshmërisë	Përmbajtja e raportimit		
1 Përkufizimet dhe Interpretimet				
1.1 – 1.7	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari		
2 Llogaritë e ndara për Bizneset e Licencuar				
2.1	B	Licencuari ka përgatitur kontabilitetet vjetore rregullative në pajtim me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitetin (URK) dhe ka dorëzuar një kopje në ZRRE jo më vonë së 3 muaj pas përfundimit të vitit financiar me të cilat kontabiliteti ndërlihet		
2.2	B	Licencuari mban llogari të ndara për OST dhe OT'n në pajtim me URK		
2.3	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari		
2.4	B	Licencuari mirëmban bazat e tarifimit, shpërndarjes dhe alokimit si në vitin financiar paraprak		
2.5	B	Licencuari është në pajtueshmëri me Nenin 12.3 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike		
2.6	B	Licencuari është në pajtueshmëri me çdo udhëzim të lëshuar nga ZRRE'ja		
3 Ndalimi i Subvencioneve dhe Ndër-subvencioneve				
3	B	Licencuari nuk ka ofruar/pranuar në mënyrë direkt ose indirekt ndonjë subvencion apo ndërrsubvencionime për/prej bizneseve tjera të tij		
4. Pajtueshmëri me Kodin e Shpërndarjes, të Rrjetit Elektrik dhe atë të Matjes				
4	B	Licencuari është në Pajtueshmëri me Kodin e Shpërndarjes, të Rrjetit dhe atë të Matjes		
5. Operimi i Sistemit të Transmisionit				

5.1	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari		
5.2 -5.3	B	Licencuari ka ndërmarr të gjitha hapat e arsyeshëm për të siguruar dhe implementuar të gjitha obligimet që vijnë nga legjislacioni i aplikueshëm dhe të licencës		
5.4	B	Licencuari ka siguruar qasje jo-diskriminuese shfrytëzuesve të sistemit ndaj informatave të nevojshme në pajtime Nenin 13.1 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike		
5.5	B	Licencuari në vendosjen e tarifave të tyre dhe ngarkesave për lidhje për përdorimin e sistemit të transmisionit ka ofruar sinjale të përshtatshme jo-diskriminuese për hyrjen në treg		
5.6	B	Licencuari ka ofruar sinjal të përshtatshëm dhe të drejtë për të lehtësuar hyrjen e lirë në treg		
5.7	B	Licencuari ka publikuar dhe bërë të disponueshme në faqen elektronike të tij deklaratat e ngarkesës për lidhje dhe përdorim të Sistemit të Transmisionit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm		
6. Plani Zhvillimor				
6.1	B	Licencuari ka përgatitur planin e zhvillimit të sistemit të transmisionit për 3 vitet në vijim ashtu siq kërkohet me legjislacion		
6.2	B	Licencuari ka rishikuar planin e zhvillimit çdo vit dhe e ka dorëzuar në ZRRE për aprovim		
7. Zotimi i Infrastrukturës				
7.1	B	Licencuari është në pajtueshmëri me zotimin ndaj infrastrukturës që rrjedhë nga Programi i Implementimit Strategjik		
7.2	B	I Licencuari raporton çdo vit në ZRRE mbi aktivitetet që kryhen prej tij, në lidhje me zotimin e infrastrukturës		
8. Balanci i Energjisë				
8.1	B	Licencuari ka propozuar në MEM një balance të energjisë afat-gjatë dhe atë vjetor në pajtim me Nenin 6 të Ligjit mbi Energjinë		
8.2	B	Licencuari ka publikuar dhe bërë të disponueshme në faqen elektronike e tyre propozimin e balancit të energjisë		
9. Disponueshmëria dhe Mirëmbajtja e të Dhënave				
9.1	B	Licencuari ka siguruar qasje jo-diskriminuese në mes përdoruesve të sistemit apo klasave të përdoruesve të sistemit në pajtim me		

		Nenin 13.1(f) të Ligjit mbi Energjinë Elektrike		
9.2	B	Licencuari ka ndërmarr të gjitha hapat e arsyeshëm për të siguruar dhe implementuar të gjitha obligimet që rrjedhin apo ndërlidhen me Legjislacionin e aplikueshëm dhe nga kjo licencë		
9.3	B	Licencuari ka dorëzuar raporte tremujore për operimin e biznesit të Sistemit të Transmisionit		
9.4	B	Licencuari ka mirëmbajtur dhe publikuar të dhënat mbi kapacitetet kufitare, interkonekcioneve, kalkulimet e rrjedhës së ngarkesës, menaxhimin dyndjes, dispeçingun e centraleve, tregjet ndihmëse dhe ato balancuese		
9.5	B	Licencuari ka mbledhur dhe mirëmbajtur të dhëna, informata dhe dokumentacionin në pajtim me Artikullin 31 të Rregullës mbi Licencimin të Aktiviteteve Energjetike të Kosovës		
10. Ndërlidhësit				
10.1	B	Licencuari ka përgatitur një procedurë për alokimin dhe shfrytëzimin e linjave ndërlidhëse me sisteme të tjera		
10.2	B	Licencuari ka përgatitur çdo dy (2) vite një listë të kapaciteteve të reja të transmisionit dhe lidhjet elektrike të interkoneksionit në bazë të nevojave regjionale për t'i plotësuar nevojat e Kosovës		
10.3	B	Licencuari deklaron se ka vepruar në pajtueshmëri me pikat a), b) dhe c) të këtij paragrafi.		
10.4	B	Licencuari vazhdon të ndërmarr rishikime ditore të kapaciteteve të deklaruara në paragrafin 3.		
10.5	B	Licencuari ka publikuar këto informata në FE të tij		
10.6	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari		
11. Operimi i Sistemit				
11.1	B	Licencuari ka lëshuar udhëzime direkte për dispeçimin e të gjitha njësive të gjenerimit që janë në dispozicion të çdo gjeneruesi		
11.2	B	I Licencuari ka ndërmarr planifikimin operative dhe ka marr parasysh faktorët e cekur në këtë paragraf		
11.3	B	Licencuari ka ofruar prioritet gjenerimit të energjisë së ripërtrishme		
11.4	B	Licencuari ka ofruar të dhëna/informata mbi operimin e sistemit në ZRRE		
11.5	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari		

12. Blerja Ekonomike e Aseteve, Shërbimeve dhe Shërbimeve Ndhmëse			
12.1	B	Licencuari ka kontraktuar ose ka prokuruar asetet dhe shërbimet ndihmëse në përputhje me legjislacionin përkatës të prokurimit, për t'i mundësuar të Licencuarit që të kryejë detyrimin e tij	
12.2	B	Licencuari ka kontraktuar apo blerë asete, shërbime dhe shërbime ndihmëse nga burimet më ekonomike që ka në dispozicion	
12.3	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari	
13. Regjistrimi dhe tjetërsimi i Aseteve Relevante			
13.1	B	Licencuari ka përgatitur regjistër të të gjithë asetëve të tij dhe dorëzuar në ZRRE këtë regjistër për qdo vit.	
13.2	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari.	
13.3	B	Licencuari është në pajtueshmëri me procedurat e aprovimit në ZRRE për tjetërsimin e asetëve	
13.4	B	Licencuari është në pajtueshmëri me procedurat e aprovimit në ZRRE për heqjen e asetëve	
13.5	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari	
14. Standardet e Sigurisë së Sistemit të Transmisionit dhe Planifikimit			
14.1	B	Licencuari ka vendosur standarde për sigurinë dhe planifikimin e sistemit dhe ka përgatitur një dokument që vendos në pah standardet brenda 12 muajve të lëshimit të Licencës	
14.2	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari	
14.3	B	Licencuari ka rishikuar standardet e sigurisë së sistemit dhe ka ofruar një raport mbi rrjedhën e rishikimit të të çfarëdo ndryshimi në ZRRE	
14.4	B	Licencuari është në pajtueshmëri me të çdo udhëzim të lëshuar nga ZRRE'ja mbi sigurinë dhe planifikimin e sistemit	
14.5	B	Licencuari ka publikuar standardet e sigurisë dhe planifikimit të sistemit në FE të tyre	
15. Standardet Operuese të Sigurisë			
15.1	B	Licencuari ka vendosur Standardet e Sigurisë së Operimit brenda 12 muajve të lëshimit të licencës	

15.2	B	Licencuari ka operuar në përputhje me standardet e sigurisë së operimit		
15.3	B	Licencuari ka rishikuar SSO dhe ka ofruar një raport mbi rishikimin në ZRRE		
15.4	B	Licencuari është në pajtueshmëri me udhëzimet e lëshuara nga ZRRE		
15.5	B	Licencuari ka publikuar SSO në FE të tij		
16. Standarde e Përgjithshme dhe Minimale gjatë përmbushjes të Biznesit të Operatorit të Transmisionit				
16.1	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari		
16.2	B	Licencuari dorëzon një tabelë të performancës brenda 12 muajve prej datës së lëshimit të licencës		
16.3	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari		
16.4	B	Licencuari ka implementuar standardet e aprovuara nga ZRRE		
16.5	B	Licencuari ka rishikuar/propozuar ndryshimet në standarde nëse e udhëzuar nga ZRRE'ja		
16.6	B	Licencuari ka ofruar të dhëna/informata/analiza në ZRRE lidhur me përmbushjen e standardeve të performancës		
16.7	B	Licencuari ka publikuar statistike lidhur me kryerjen apo moskryerjen e veprimtarisë sipas standardeve, ashtu si është kërkuar nga ZRRE'ja,		
16.8	B	Licencuari ka qenë objektiv dhe jo diskriminues gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij dhe në pajtim me Nenin 13.1 të Ligjit për Energji Elektrike		
17. Qasje në Tokën dhe/ose në Ndërtesa				
17.1	B	Licencuari ka përgatitur Kodin e Punës brenda afatit të caktuar në licencë		
17.2	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari		
17.3	B	Licencuari ka rishikuar periodikisht Kodin e Punës		
17.4	B	Licencuari vepron në pajtim me Kodin e Punës		

18. Kufizimet në përdorimin e informatave përkatëse			
18.1 – 18.5	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari	
19. Sigurimi i informatave për Operatorë tjerë të Sistemit dhe OSSH			
19.1	B	Licencuari u ka dorëzuar të dhëna/informata OSSH-së dhe Operatorëve tjerë të Sistemit në mënyrë që të sigurojë funksionim efikas, zhvillimin e koordinuar dhe ndërfunksionimin e sistemeve të ndërlidhura	
19.2	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari	
20. Kodi i Sjelljes së Operatorit të Sistemit të Transmisionit			
20.1	B	Licencuari ka përgatitur Kodin e Sjelljes dhe dorëzuar atë në ZRRE brenda afatit të paraparë me licencë	
20.2- 20.3	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari	
20.4	B	Licencuari ka publikuar Kodin e Sjelljes në FE të tij	
21. Rregullat e Tregut			
21	B	Licencuari është në pajtueshmëri me Rregullat e Tregut	
22. Shëndeti dhe Siguria			
22.1	B	Hapa të arsyeshëm janë ndërmarr nga i Licencuari për mbrojtjen e personave dhe pronës	
22.2	B	Audit teknik dhe i sigurisë është ndërmarr në sistemin e transmisionit nga një ekspert i pavarur i aprovuar nga ZRRE'ja	
22.3	B	Rezultatet e auditimit e tillë janë dorëzuar në kohën e duhur në ZRRE	
23. Puna			
23	B	Licencuari është në pajtueshmëri me Legjislacionin e Punës në Fuqi	
24. Obligimi i Sigurimit			
24	B	Licencuari ka lidh kontrata për sigurimin e aseteve dhe pajisjeve e tija dhe ka dorëzuar kontratat në ZRRE për rishikim	

25. Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit			
25	A	I Licencuari ka vepruar në pajtim me këtë Nen.	
26. Shërbimeve Publike të Detyrueshme			
26	B	Licencuari është në pajtueshmëri me çdo obligim të Shërbimit Publik të vendosur nga ZRRE'ja e sipas Nenit 51 të LRE.	
27. Sigurimi i Informatave për ZRRE'n			
27.1	B	Licencuari ka dorëzuar të dhëna/informata në ZRRE sikurse është kërkuar nga ajo	
27.2 -27.4	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari	
27.5	B	Licencuari ka dorëzuar në ZRRE një raport tremujor dhe vjetor duke informuar për biznesin e Operatorit të Sistemit të Transmisionit	
27.6	B	I Licencuari ka dërguar në ZRRE detajet e çdo ndryshimi në informata të dërguara me aplikacion për licencë	
27.7	B	Raporti vjetor mbi statusin e pajisjeve kryesore dhe kontinuitetit të furnizimeve me të dhënat është dorëzuar në ZRRE	
27.8	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari	
28. Arsyet për përfundimin, tërheqjen dhe modifikimin e licencës			
28.1 – 28.3	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari	
29. Masat dhe Gjobat Administrative			
29.1 – 29.8	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari	
30. Zgjidhja e Kontesteve			
30.1 - 30.2	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari	

Tabela për Monitorimin e Kushteve të Licencës për Operatorin e Tregut

Ref. e Licencës	Niveli i Pajtushmërisë	Përmbajtja e raportimit
1 Përkufizimet dhe Interpretimet		
1.1 – 1.7	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari
2. Autorizimet e dhëna sipas kësaj Licence		
2.1	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari
2.2	B	Licencuari nuk ka transferuar ndonjë nga të drejtat ose detyrimet e veta që i janë dhënë me anë të kësaj licence
3. Llogaritë e Ndara për Biznesin e Operimit të Tregut		
3.1	B	I Licencuari ka përgatitë llogaritë vjetore rregullative në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitetin dhe dorëzuar në ZRRE brenda afatit të paraparë
3.2	B	I Licencuari në kontabilitetin e tij të brendshëm i mbanë ndamas llogaritë e biznesit të operimit të tregut nga veprimtaria e Operatorit të Sistemit të Transmisionit
3.3	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari
3.4	B	Licencuari nuk do të ndryshojë bazat e tarifimit, shpërndarjes ose alokimit që janë përdorur në vitin financiar paraprak
3.5	B	Licencuari është në pajtueshmëri me çdo udhëzim të lëshuar nga ZRRE'ja
4. Detyrimet e Shturjes Ligjore dhe të Menaxhimit		
4.1	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari
4.2	B	Licencuari nuk është i angazhuar në gjenerim, furnizim apo tregtim të energjisë elektrike
4.3	B	Licencuari ka mbajtur pavarësinë e përcaktuar me pikat a), b) dhe c)

5. Ndalimi i Subvencioneve dhe Ndër-subvencioneve		
5.1	B	Licencuari nuk ka ofruar/pranuar në mënyrë jo direkt ose indirekt ndërrsubvencionime prej bizneseve apo vartësi/partneri të tij
6. Ndalimi i diskriminimit		
6.1	B	Licencuari nuk ka bërë diskriminim ndaj palëve tregtare
6.2	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari
7. Rregullat e Tregut		
7.1	B	Licencuari ka përgatitur dhe dorëzuar në ZRRE për miratim Rregullat e Tregut sipas afatit të paraparë në licencë
7.2	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari
7.3	B	Çdo modifikim i Rregullave të Tregut është menaxhuar nga i Licencuari
7.4	B	Rregullat e Tregut janë të publikuara në FE e të Licencuarit
8. Qasja në Rregullat e Tregut		
8.1	B	Marrëveshja për Qasje është nënshkruar me të gjithë personat që dëshirojnë ta bëjnë këtë
8.2	B	Licencuari ka monitoruar pajtueshmërinë e palëve tregtare me Marrëveshjen për Qasjen e në përputhje me Rregullat e Tregut
8.3 - 8.4	-	Nuk ka raportim nga i Licencuari
9. Komunikimet Operacionale		
